



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 262/1 Prot.

Tiranë, më 13 . 04 . 2021

Shpallje e kërkesës për aplikime për hartues të programit orientues dhe të fondit të pyetjeve të provimit të shtetit, për profesionin e rregulluar të psikologut

Qendra e Shërbimeve Arsimore shpall thirrjen për shprehje interesi për hartues të programit orientues dhe fondit të pyetjeve të provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të psikologut.

Kriteret:

Të interesuarit për hartues të programit orientues dhe fondit të pyetjeve të provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të psikologut, duhet të plotësojnë kriteret si vijon:

- a) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në IAL si personel akademik me kohë të plotë;
- b) të ketë së paku gradën shkencore "Doktor";
- c) përbën avantazh të ketë trajnime në metodikën e hartimit të pyetjeve.

Kandidatët e interesuar, përpara se të fillojnë përgatitjen e dokumenteve për aplikim, duhet të sigurohen që i plotësojnë kriteret e shpallura për përzgjedhjen e kandidatëve.

Aplikimi:

Dokumentet e nevojshme që kandidati i interesuar duhet të dorëzojë, dhe mënyra e aplikimit përcaktohet si më poshtë. Të dhënat e kandidatëve do të grumbullohen duke respektuar Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

1. formularin i aplikimit sipas formatit të publikuar nga QSHA në thirrjen publike;
2. jetëshkrimin;
3. fotokopje të letërnjoftimit (ID);
4. fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
5. fotokopje të dokumentacionit që provon zotërimin e gradës shkencore “Doktor”;

Procedura e aplikimit:

Qendra e Shërbimeve Arsimore do të pranojë vetëm aplikime që janë përcjellë me postë në QSHA. Nuk pranohen aplikime dorazi.

Afati i dorëzimit të aplikimeve:

Aplikimet do të drejtohen në QSHA, duke filluar nga data 14.01.2021 deri më 15.02.2021.

Qendra e Shërbimeve Arsimore organizon procesin e pranimit, shqyrtimit të aplikimit dhe përzgjedhjes së hartuesve sipas rregullores “Për funksionimin e Komisionit të Provimit të Shtetit dhe procedurat e zhvillimit të provimit të shtetit”, të miratuar nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë me urdhrin nr.365, datë 28.12.2020, të cilën e gjeni të publikuar në faqen e internetit të institucionit.

DREJTORE E PËRGJITHSHME

Rezana VRAPI

